



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1330/ Prot.

Durrës, më 26.05 2026

**VENDIM**

Nr. 44, datë 26.05 2026

**"PËR MIRATIMIN E TERMAVE FINANCIARË TË RREGULLORES PËR  
FUNKSIONIMIN E REVISTËS SHKENCORE "INTERDISCIPLINARY JOURNAL  
OF RESEARCH AND DEVELOPMENT (IJRD)"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Rregullores Financiare, Vendimit të Senatit Akademik nr. 69, datë 15.05.2026 "Për disa saktësime në vendimin nr. 61, datë 23.04.2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Senatit Akademik nr. 159, datë 21.11.2025 për miratimin e rregullores për funksionimin e revistës shkencore universitare Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD)", Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e termave financiarë të Rregullores për funksionimin e Revistës Shkencore Universitare "Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD)" sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - Zv.Rektor për Kërkimin Shkencor
  - Administratori
  - Drejtoria e Administrimit Financiar
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

